



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Të ftuar:

Julian Hodo – Zëvendësministër i Brendshëm.

Emirjola Yzeiraj – Përfaqësuese nga Sektori i Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme.

Renata Balliu – Përgjegjëse në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore.

Arlinda Gjata - Specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Edmond Rrushi, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Alban Zeneli, Anduel Xhindi, Lefter Maliqi, Luan Harusha, Arben Elezi, Elena Xhina, Myslim Murrizi, Xhemal Qefalia, Nimet Musaj.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Ylli Shehu.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës për këtë mbledhje kemi miratimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Për të prezantuar përmbajtjen e këtij projektligji, instrument me anë të të cilit ne aderojmë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës, kemi të ftuar përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. Konkretisht, të ftuar kemi zotin Julian Hodo, zëvendësministër i Brendshëm, zonjën Emiriola Yzeiraj, përfaqësuese nga Sektori i Marrëveshjeve të Ministrisë së Brendshme, zonjën Renata Balliu, përgjegjëse në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore, si dhe zonjën Arlinda Gjata.

Faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Relator nga ana e Komisionit të Sigurisë për këtë projekt do të jetë kolegu Duzha.

Fjalën e ka zëvendësministri i Brendshëm për të bërë prezantimin e projektligjit, për të sqaruar pse vjen tani ky aderim në këtë konventë, sepse shikojmë që konventa daton shumë kohë më parë dhe pse Shqipëria detyrohet të bëhet pjesë pikërisht në këtë moment. Çfarë të mirash përfiton vendi ynë nga aderimi në Konventën Ndërkombëtare Kundër Falsifikimit të Monedhës.

Fjala është për ju, zoti Hodo. Më pas do ta marrë fjalën kolegu Duzha.

Faleminderit!

Julian Hodo – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Sigurisë,

Siç e përmendi edhe kryetarja, ju keni përpara projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Duke i dhënë që në fillim një shpjegim shqetësimit të zonjës kryetare, është e vërtetë që kjo konventë është nënshkruar që në vitin 1929, por na ka rezultuar se që nga ai vit nuk është bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm, sepse nuk është depozituar dhe nuk është aprovuar kurrë një instrument ratifikimi.

Në kuadër të planit kombëtar të integritetit europian dhe të programit analitik të akteve të Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke analizuar edhe përmbajtjen, ka gjykuar të arsyeshme të propozojë aderimin në këtë konventë pikërisht për të

forcuar parandalimin, hetimin dhe dënimin e veprave penale që lidhen me falsifikimin e monedhës.

Sipas *side*-it të konventës, nuk rezulton që të jetë depozituar kurrë një instrument ratifikimi nga ana e Republikës së Shqipërisë, nuk është depozituar asnjë rast denoncimi po nga ana e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë heqje dorë apo tërheqje nga konventa, si dhe vetë konventa nuk ka asnjë afat, qoftë për ratifikimin, qoftë për heqjen dorë.

Duke pasur parasysh mekanizmin që ndërtohet në këtë konventë, është gjykuar si e nevojshme çuarja përpara e kësaj ideje, pra, ratifikimi dhe bërja pjesë e rendit juridik të brendshëm.

Pjesa kryesore është që konventa parashikon një përcaktim të mirë të sjelljeve të ndaluara, që nga prodhimi i monedhave të falsifikuara, shpërndarja, hedhja e tyre në treg, përdorimi, me qëllim marrjen e përfitimeve nga ana e kësaj.

Projektligji dhe konventa janë dërguar për mendim tek të gjitha institucionet, si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe Banka e Shqipërisë, që është organi emetues i monedhave.

Pjesa kryesore që parashikohet në konventë është që qendërohet parandalimi dhe hetimi i këtyre veprave penale. Do të thotë që krijohet një zyrë qendrore, e cila krijon një kanal komunikimi direkt me homologët e saj në vendet e tjera duke siguruar një akses dhe qarkullim më të shpejtë të informacionit, pra, krijimi i një rrjeti ndërkombëtar me qëllim luftën për parandalimin e këtij fenomeni.

Në fakt, Ministria e Drejtësisë ka sugjeruar që të mos bëhet fjalë për ratifikim, por për aderim, sepse, sipas ligjit nr. 43, të vitit 2016, kur bëhet fjalë për ratifikim, kërkesa për ratifikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve, kurse në rastin konkret ka kaluar shumë kohë.

Gjithsesi, është një instrument i vlefshëm që shkon në drejtim me politikat e Ministrisë së Brendshme dhe impenjimet konkrete të Policisë së Shtetit për sa i përket luftës kundër krimit, duke pasur parasysh që edhe falsifikimi dhe qarkullimi i monedhave të falsifikuara është shpeshherë problem edhe për ekonominë.

Nga Prokuroria e Përgjithshme është sugjeruar që të çohet përpara ky projektligj, duke sugjeruar edhe ndryshime të mëtejshme të Kodit Penal, që besoj se do të paraqiten shumë shpejt në mënyrë që të harmonizohet dhe të unifikohet edhe gjuha e përdorur, sepse, siç e thatë edhe ju, duke pasur parasysh se kemi një tekst relativisht të vjetër, duhet që edhe gjuha e përdorur të harmonizohet me termat modernë që përcaktojnë fenomene të caktuara.

Gjithashtu, kemi opinion pozitiv edhe nga Banka e Shqipërisë, që është organi emetues dhe kontrollues i tregut financiar në Republikën e Shqipërisë.

Aderimi në këtë konventë ka edhe kosto financiare për krijimin e zyrës qendrore dhe personelin përkatës, por nuk do të ketë efekte mbi buxhetin shtesë, sepse është menduar që kjo zyrë qendrore të krijohet brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pra, për sa i përket ambienteve do të jetë në të njëjtën seli, por edhe për sa i përket personelit që do të përdoret do të jetë personeli i Policisë së Shtetit, bazuar në buxhetin e këtij viti dhe të atij pasardhës, natyrisht.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodo!

Po, zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu sikurse e tha edhe zëvendësministri, projektligji ka për qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës. Kjo konventë bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor në fushën e falsifikimit të monedhës.

Me anë të aderimit vendi ynë merr përsipër të drejta dhe detyrime që lindin nga kuadri ndërkombëtar ligjor, si dhe siguron parandalimin dhe dënimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare, duke shkëmbyer informacion me anë të zyrës qendrore.

Ky bashkëpunim pritet të realizojë objektivat në lidhje me evidentimin e shkeljeve dhe marrjen e masave të përbashkëta në luftën kundër falsifikimit të monedhës, duke respektuar legjislacionin ndërkombëtar në fuqi.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj konvente kanë të bëjnë me luftën kundër falsifikimit të monedhës, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit. Palët kontraktuese do të konsultohen në lidhje me problematikat që mund të lindin brenda kuadrit ligjor vendas dhe do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër veprës së falsifikimit të monedhës. Hetimet mbi subjektin e falsifikimit do të organizohen nga një zyrë qendrore, e cila do të krijojë komunikim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.

Prandaj, ju lutem kolegë, kërkoj ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit kolegut të Ministrisë së Brendshme dhe kolegut Duzha!

Besoj se ia vlen të bëjmë disa pyetje për sa i përket aderimit në këtë konventë.

Kështu që, pa humbur kohë, fjalën e ka zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, këtu shikoj që kemi vetëm një vendim, që do të kalojë në Kuvend, për ratifikimin e marrëveshjes, kurse në fjalën shpjeguese të zëvendësministrit u tha që do të ketë masa shtrënguese.

Së pari, është parashikuar të bëhet një ligj pasi të miratohet ratifikimi i marrëveshjes në Kuvend, sepse këtu nuk po shikoj masa shtrënguese?

Së dyti në cilësinë e zëvendësministrit të Brendshëm, nga historiku ndër vite i konstatimeve të kësaj vepre penale në Shqipëri dhe nga hetimi i organeve hetimore apo institucioni i Ministrisë së Brendshme, rezulton që falsifikimi i monedhave që përdoren në tregun shqiptar bëhet në Shqipëri apo vjen monedhë e falsifikuar nga jashtë vendit?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Po, zoti Hodo.

Julian Hodo - Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket pyetjes së parë, projektligji për aderimin shoqërohet me masa organizative. Pra, duke aderuar në këtë konventë automatikisht nocionet e kësaj konvente përthithen nga legjislacioni vendas dhe shoqërohen me masa organizative për krijimin e strukturave përkatëse që do të bëjnë këtë lloj pune specifike, që është krijimi i zyrës qendrore dhe personelit përkatës, me qëllim shkëmbimin e informacionit në kohë reale për një seri sjelljesh.

Për sa i përket pyetjes nëse falsifikimi i monedhave bëhet kryesisht në Shqipëri apo jashtë vendit, duhet të themi se eksperiencia ndër vite tregon që më së shumti monedhat e falsifikuara vijnë nga jashtë, kjo edhe për shkak të specifikës së teknikës që duhet.

Gjithsesi, sipas kësaj konvente, të gjitha vendet anëtare kanë detyrimin të shkëmbejnë informacion në kohë sa më të shpejtë, qoftë për falsifikimin e monedhave vendase, qoftë për falsifikimin e monedhave të huaja, që ndodhin në territorit e tyre. Kjo ndodh anasjelltas.

Pra, në rastin që Shqipëria konstaton që monedha të falsifikuara shqiptare apo të huaja përdoren dhe kanë dijeni edhe për vendin e origjinës së tyre, menjëherë qarkullohet informacioni me të gjitha shtetet anëtare nëpërmjet zyrës qendrore. Kjo mundëson një hetim më të plotë dhe gjithëpërfshirës të fenomenit.

Myslim Murrizi – Për strukturat që do të krijohen enkas, në bazë të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, jam dakord, por për masat shtrënguese do të ketë ndërhyrje në Kodin Penal?

Julian Hodo – Ky është një sugjerim që ka ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, edhe për shkak të faktit që duhet të harmonizohet gjuha e përdorur ndërmjet konventës dhe legjislacionit shqiptar. Është një sugjerim vetëm i Prokurorisë së Përgjithshme. Besoj se ne po e marrim në konsideratë shumë seriozisht dhe me projektin e ndryshimeve të reja, që mund të paraqiten për Kodin Penal, do të shikohet edhe mundësia e paraqitjes të dispozitës specifike për këtë qëllim.

Ermonela Felaj – Megjithatë, dispozitën përkatëse për falsifikimin e monedhës ne e kemi në Kodin Penal që prej vitit 1995. Pastaj, mënyra si është zbatuar është tjetër diskutim. Unë besoj se është e nevojshme të krahasohen të gjitha të dhënat, rekordet e kësaj veprë penale në Shqipëri, me atë çfarë parashikon konventa.

Në vija të përgjithshme duket qartë që mbahet i njëjti qëllim; hedhja në qarkullim e monedhave të falsifikuara, qofshin këto vendase apo monedha të tjera. Pikërisht përdorimi i tyre, me qëllim që ato të jenë në qarkullim dhe nga qarkullimi i tyre të përfitohet, sigurisht që është e dënueshme në Shqipëri dhe në çdo vend tjetër. Besoj se Konventa na jep mundësinë që të krijojmë zyrën qendrore, e cila lehtëson marrëdhënien juridiksionale, pra marrëdhëniet me shtetet e huaja, sepse marrja e informacionit në kohë të shpejtë i shërben hetimit më të plotë dhe më të mirë të kryerjes së kësaj veprë.

Besoj se pyetje të tjera nga kolegët mund të hedhin më shumë dritë për përmbajtjen e Konventës dhe nevojën që kemi pasur ne për të bërë këtë aderim.

Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha - Si do të jetë struktura e kësaj zyre qendrore; sa do të jetë stafi i saj dhe si do të kryhen pagesat e tyre?

Faleminderit!

Julian Hodaj – Njerëzit dhe buxhetet përkatëse janë duke u vendosur. Gjithsesi, ideja fillestare është se do të krijohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda departamentit të policisë kriminale, meqenëse kjo lloj strukture duket si më e duhura për ta adresuar këtë lloj fenomeni, por është ende herët. Pra, pa kaluar projektligji, nuk mund të flasim për terma njerëzish dhe buxhetesh.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

A keni pyetje të tjera?

Në fakt, zoti Hodaj e sqaroi edhe gjatë fjalës së tij prezantuese se ngritja e zyrës qendrore nuk parashikohet që të ketë kosto, për faktin se e gjitha do të ndodhë me kapacitetet njerëzore që ka Policia e Shtetit dhe mjediset që disponon Policia e Shtetit.

Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha – Zoti Hodaj, ka pasur ndonjë indicie për ngritjen e kësaj zyre në Shqipëri? Pra, a keni identifikuar raste gjatë kësaj kohe?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Harusha!

Besoj se është rasti që të sqarojmë se cili ishte shkaku që të aderojmë pikërisht tani në këtë konventë.

Julian Hodaj – Besoj se të gjithë jemi në dijeni që Shqipëria ka ndërmarrë një proces për përafrimin e legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Europian. Në kuadër të kapitullit XXIV “Liria, drejtësia dhe siguria”, pasi bëhet një *screening* i thellë i legjislacionit ekzistues dhe krahasohet me parametrat ndërkombëtarë dhe europianë, duhej edhe të adoptohej një instrument i tillë. Duke qenë se Shqipëria e paska ratifikuar këtë Konventë që në vitin 1929, por kurrë nuk është bërë pjesë e eventit të brendshëm ishte më e arsyeshme të procedohej me aderimin në këtë lloj instrumenti dhe shfrytëzimin e atij rrjeti ekzistues se sa të procedohej me një ligj special për krijimin e një instrumenti tjetër, ndoshta edhe vendas, që do të haste po gjithmonë atë problem që normalisht autoritet vendase kanë në komunikimin me autoritetet e huaja. Pra, shfrytëzojmë një rrjet të ngritur dhe meqenëse ekzistonte, atëherë shfrytëzohet kjo mundësi deri në fund. Besoj se ju të gjithë keni dëgjuar raste sporadike. Nuk është ndonjë fenomen shumë i theksuar, por, gjithsesi, duhet ta theksojmë fort. Për sa kohë tentojmë ta përafrojmë legjislacionin me standardet ndërkombëtare dhe standardet e BE-së, një hap i tillë ishte i domosdoshëm.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për prezantimin!

Ju në relacionin, që shoqëron projektligjin thoni: “Ngritja e zyrës qendrore nuk do të ketë kosto shtesë personeli, i cili do të merret me këtë punë. Nuk do të ketë efekte financiare, pasi do të përballohet me personelin, i cili është pjesë e strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

Pyetja ime është: personeli i cili do të merret me këtë, a është i trajnuar, a ka kapacitete që ta përballojë këtë ngarkesë?

Së dyti, në vitin 2019 a ka pasur raste të ndjekjeve penale, të personave, të cilët kanë falsifikuar monedhat dhe sa është numri i tyre?

Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj - Për sa i përket pyetjes së parë, duhet të them se në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në departamentin e policisë kriminale, ekziston një njësi e

veçantë për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar. Mendojmë se ekspertiza e atyre punonjësve dhe e personelit të angazhuar në këtë lloj aktiviteti, është mjaft afër asaj që kërkohet të bëjnë në të ardhmen, për sa kohë që bëhet fjalë për krime dhe vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me aspektet ekonomiko-financiare.

Për sa i përket pyetjes së dytë, mund t'ju them pak më vonë këtë lloj informacioni në lidhje me sasinë e saktë. Ashtu siç e përmenda më sipër, raste ka gjithmonë dhe besoj se do të ketë. Ideja është që forcohen mekanizmat e parandalimit dhe të luftës ndaj këtyre fenomeneve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka pyetje nga kolegët e tjerë?

Zoti Murrizi, më duket se kishit një sqarim?

Myslim Murrizi – Të them të drejtën, nuk kam pyetje, por, më vjen mirë, që shikoj se Shqipëria ka aderuar në këtë konventë që në vitin 1929. Ajo që shikoj jo me dashamirësi, por me njëfarë keqardhje është se sot jemi 90 vjet më pas dhe vijmë për të zbatuar një marrëveshje të ratifikuar nga qeveria e Ahmet Zogut, ndërkohë që për 45 vjet kemi dëgjuar lloj-lloj xhevahirësh për të. Nuk dua që të trumbetohet akti i ratifikimit të marrëveshjes për monedhat false nga mediet më shumë dhe të mos gjykohet nga këta se ne kemi marrë shkas ta ratifikojmë marrëveshjen meqenëse është dënuar Agim Kajmaku për monedhash false.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për përdorues akuzohet.

E ruajtë Zoti, Sadi, por do të ishte mirë ta kishim ratifikuar pak më parë marrëveshjen e masës shtrënguese, siç thotë zëvendësministri dhe që unë jam dakord...

Ajo që dua unë, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, është të mos marrim përsipër të gjitha të zezat që bëhen në botë, sikur i bëjmë ne shqiptarët. Unë kam bindjen absolute se nuk kemi as mundësinë, as aftësinë dhe as teknologjinë që këtu te ne të prodhohen monedha false, sepse këta vijnë nga ustallarë, që e dinë se ku e ka burimin prodhimi i monedhës, në Zvicër apo ku prodhohet ajo. Po të jenë kaq të zotët shqiptarët dhe arrijnë të prodhojnë monedhën false të huaj dhe të vendit, do ta kishim harruar krizën që kemi dhe nuk do të ikte asnjë njeri jashtë shtetit dhe, në vend të serrave, do të kishin hapur minilaboratorë nëpër shtëpia për të prodhuar monedha false. Prandaj, ky është një fenomen që na vjen nga importi. Është mirë që ato vende, të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen në vitin 1929, të bëjnë kujdes dhe të mos na helmojnë me paratë false nga vijnë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Murrizi!

Kuptohet që aderimi në konventë është një detyrim formal në kuadër të procesit të hapjes së negociatave, i cili e vë Shqipërinë para përgjegjësisë për të përshtatur legjislacionin e vet me atë ndërkombëtar, kryesisht të Bashkimit Europian, por edhe për ta plotësuar, aty ku ai nuk është konsoliduar. Kështu që qartësisht unë nuk mendoj se aderimi në këtë konventë heq faktin se në kode të ndryshme penale apo në kohë të ndryshme, që ne kemi pasur Kodin Penal, ne e kemi dënuar këtë vepër, qoftë falsifikimin e monedhës në çfarëdo lloj forme të jetë ajo, kartmonedhë apo monedhë, po ashtu dënohet edhe vënia në përdorim e saj, gjithmonë kur provohet dijenia për qenien e falsifikuar të parasë. Pra, ky ka qenë një standard i pandryshuar në vendin tonë dhe besoj se i ka krijuar rekordet e qarta të hetimit dhe gjyqimit të kësaj veprë penale.

Nëse nuk ka pyetje të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe monedhë metalike, por ka edhe monedhë letër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala monedhë, siç përdoret në Konventë dhe në Kodin Penal, përfshin të gjitha këto kuptime dhe instrumentet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo vit për të dhënat e veprës penale në fjalë mund të konsultohemi me raportin e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili është një raport publik, por ju siguroj që nuk është një vepër aq e përhapur, është një vepër e limituar për sa i takon kryerjes së saj dhe besoj se vazhdimisht është goditur në kohë.

Po, zoti Hodaj.

Julian Hodaj- Kam një ndërhyrje të shkurtër vetëm për t'iu përgjigjur shqetësimit të drejtë të zotit deputet. Në asnjë moment në relacion apo në propozimin e qeverisë nuk thuhet apo pranohet që të jetë një fenomen vendas. Ajo që thuhet dhe pranohet është se neve na takon ta harmonizojmë dhe modernizojmë legjislacionin dhe, në këtë kuadër, duhet gjetur instrumenti i përshtatshëm. Ne kishim një instrument gati, i cili është nënshkruar, kjo që po bëjmë sot është akti i aderimit, dhe është pjesë e detyrimeve që ne kemi marrë në kuadër të kapitullit XXIV, “Liria, drejtësia dhe siguria”.

Ermonela Felaj – Kalojmë në miratimin e projektligjit.

Ju ftoj të kalojmë te faqja e dytë e praktikës dokumentare që keni përpara!

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord me nenin 2? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

Nesër në orën 09:00 ne parashikojmë që të shkojmë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë.

MBYLLET MBLEDHJA